



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATE



NIPT. M01321051K

Nr.12/2020.Dosje/Nr.79.Prot.

Tiranë, më 09.03.2020

URDHËR

(PËR VENIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE)

Drejtuar: Qendres Kombetare te Biznesit QKB-Tirane

Une Endrit Hasa, me detyre Përmbaarues Gjyqësor dhe NIPT M01321051K, në referim të Titujve Ekzekutiv, Fatura Tatimore Nr.16, date 11.05.2019, Fatura Tatimore Nr.18, date 11.05.2019, Fatura Tatimore Nr. 20, date 01.06.2019, Fatura Tatimore Nr. 22, date 01.06.2019, kam vënë në ekzekutim keta Tituj, duke regjistruar në dosjen përmbarimore Nr.12/2020, datë 24.02.2020, kërkesën e kreditorit Arjan Zykollari PF, ndaj debitorit Shoqeria "Alba Cosmetic 2014" sh.p.k, ku është lëshuar Urdhëri i Ekzekutimit Vendimi Nr.(11-2019-6986)1367, date. 13.12.2019 i Gjykates se Rrethit Gjyqësor Durres, pasi studiova materialet e dosjes përmbarimore Nr.12/2020, datë 24.02.2020, konstatoj se:

Në bazë të Urdherit të Ekzekutimit Vendimi Nr.(11-2019-6986)1367, date. 13.12.2019 i Gjykates se Rrethit Gjyqësor Durres, është vendosur :

1. Pranimin e kerkeses se kerkuesit Arjan Zykollari person fizik.
2. Leshimin e urdherit te ekzekutimit per Faturat Tatimore shitjes :
 - Fatura Tatimore Nr.16, me seri Nr.18247164, date 11.05.2019 ne vleren e mbetur te palikujduar leke 50.100 (pesedhjete mije e njeqind) leke.
 - Fatura Tatimore Nr.18, me seri Nr. 18247166, date 11.05.2019 ne vleren e plote prej leke 200.000 (dyqind mije) leke.
 - Fatura Tatimore Nr. 20, me seri Nr. 18247168, date 01.06.2019 ne vleren e plote prej 1.851 (nje mije e teteqind e pesedhjete e nje) Euro.
 - Fatura Tatimore Nr. 22, me seri Nr. 18247170, date 01.06.2019 ne vleren e mbetur te palikujduar leke 464.050 (katerqind e gjashtedhjete e kater mije e pesedhjete) leke.
3. Totali i faturave 714.150 leke dhe 1851 euro.
4. Ky vendim leshohet ne nje kopje te vetme,
5. Ngarkohet sherbimi permbarimor per ekzekutimin e ketij vendimi.
6. Shpenzimet gjyqesore ne ngarkim te pales kerkuese

Bazuar në nenin 517 të Kodit të Procedurës Civile, paragrafët I dhe II të tij, lajmërova dhe kërkova përmbushjen dhe ekzekutimin vullnetarisht të detyrimit që përmban Tituli i Ekzekutimit Vendimi Nr.(11-2019-6986)1367, date. 13.12.2019 i Gjykates se Rrethit Gjyqësor Durres, duke respektuar afatin 10-ditor, që prej marrjes së këtij lajmërimi.

Debitori Shoqeria "Alba Cosmetic 2014" shpk, me NIPT L42224502H, ka marrë njoftimin e Lajmërimit për Ekzekutimin Vullnetar të Detyrimit dhe nuk i është përgjigjur respektimit të afatit dhe kërkesave të këtij lajmërimi. Në këto kushte në referim të nenit 519, 527 të K.Pr.Civile është vijuar me ekzekutimin e detyrueshëm, duke vënë sekuestër mbi sendet e luajtshme të palës debitorë Shoqeria "Alba Cosmetic 2014" shpk, me NIPT L42224502H, në masën e nevojshme për plotësimin e detyrimit.

Përsa më sipër, në referim të nenit 519, 527 i K.Pr.Civile dhe të Ligjit Nr. 26, Datë 08.05.2019 "Për Shërbimin Përmbarimor Gjyqësor Privat.

URDHËROJ:

1. Vendosijen e shënimit në regjistrat e QKB-së, për subjektin Shoqeria "Alba Cosmetic 2014" shpk, me NIPT L42224502H me Administrator, Z. Adi Mehmeti, si më poshtë:

Ndalimin e tjetërsimit të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme dhe të drejtave reale mbi kredit e debitorit, Shoqeria "Alba Cosmetic 2014" shpk, me NIPT L42224502H me Administrator Z. Adi Mehmeti, duke paralajmëruar çdo zyrtarë noterialë se çdo akt i ndërmarë pas këtij shënimi përbën shkelje ligjore referuar nenit 531 e vijues të K.Pr.Civile, të Ligjit nr.7829 datë 01.06.1994 "Për noterinë" dhe nenit 428 dhe 320 i K.Penal.

2. Ky urdhër të qëndroj i regjistruar në regjistrat e QKB-së deri në shlyerjen e plotë të detyrimit në zbatim të Urdhërit të Ekzekutimit Vendimi Nr.(11-2019-6986)1367, date. 13.12.2019 i Gjykates se Rrethit Gjyqësor Durres.
3. Për informimin, bllokimin dhe veprimet që duhet të kryeni pas marrjes së njoftimit të këtij urdhri në lidhje me debitorin e sipërpërmendur të njoftohem në rrugë zyrtare brenda afatit administrativ nga ana Juaj.
4. Personat që bëhen pengesë, apo të cilët i paraprijnë ndonjë ndryshimi të mundshëm të pronësisë së pasurive të luajtshme apo të paluajtshme në emër të debitorit përmendur në pikën 1, brenda afatit të përgjigjes zyrtare, që nga dita e njoftimit të këtij urdhri, do të përgjigjen sipas Nenit 606/3 Kodi i Procedurës Civile dhe 320 i Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë.
5. Ky urdhër mbahet në 4 kopje, dhe u njoftohet palëve të cilat kanë të drejtën e ankimit në gjykatë brenda 5 ditëve, nga dita e marrjes dijeni.

Përmbarues GJYQËSOR
Endrit Z. Hasa

